



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:910285

Datë: 21.09.2021

Numri i dokumentit: 02195670

**Ac.nr.1573/2017**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit, dhe Nenad Llaziq e Makifete Saliuka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve Y.M. dhe S.M. të dytë nga fshati ... Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tij av.R.B. nga Prizreni, kundër të paditurit Q.D. nga Peja, të cilin e përfaqësojnë të autorizuarit e tij av. A.K. nga Peja dhe i biri i tij B.D. nga Peja, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr. 1004/2015 të datës 16.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 09.09.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e paditësve Y.M. dhe S.M. të dytë nga fshati ... Komuna e Pejës, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 1004/2015 të datës 16.11.2016.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësve Y.M. dhe S.M. të dytë nga fshati ... Komuna e Pejës, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit në bazë të posedimit-vjetërsimit fitues janë pronar secili prej tyre nga ½ në ngastrën Kadastrale 49 Zona Kadastrale Bogë dhe të detyrohet i padituri Q.D. që të pranoi këtë fakt dhe të durojë që kjo paluajtshmëri të evidentohet në emër të paditësve, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, si tërësisht e pa bazuar. Nën II të dispozitivit është detyruar paditësi Y.M. dhe S.M., që në emër të shpenzimeve të procedurës në mënyrë solidare t'ia paguajnë të paditurit Q.D. shumën në lartësi prej 2092,00 euro, në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësve av. R.B. nga Prizreni, për shkak të :

- Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,
- Vërtetimit të gabuar jo të plotë të gjendjes faktike dhe

- Zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ta aprovtojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e goditur ta ndryshojë duke aprovuar kërkesëpadinë në tërësi të paditësve si të bazuar ose ta prish dhe lëndën ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, dhe të detyroi me shpenzimet e procedurës të paditurin.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i të paditurit, me propozim që të refuzohet ankesa e të autorizuarit të paditësve, ndërsa aktgjykimin i goditur të vërtetohet.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në pajtim me nenin 194 të LPK, në kuadër të kufijve të pretendimeve ankimore dhe duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së të parapara me nenin 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës del se paditësit kanë parashtruar padi, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit në bazë të posedimit-parashkrimit fitues janë pronar secili prej tyre nga 1/2 në ngastrën Kadastrale 349 ZK Bogë dhe të detyrohet i padituri Q.D. që të pranoi këtë fakt dhe të duroi që kjo paluajtshmëri të evidentohet në emër të paditësve, të gjitha këto brenda afatit 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marr aktgjykimin më afër të përshkruar si më lart, duke gjetur se nuk është kontestuese fakti se paluajtshmëria kontestuese nr.349 ZK Bogë, që nga viti 1932 e këndeje evidentohet në emër të paraardhësit të paditurit S. (S.) C. ish nga fshati Bogë Komuna e Pejës, përndryshe gjyshi i të paditurit, kurse që nga viti 1944, në emër të M. C.D. ish nga fshati Bogë Komuna e Pejës, përndryshe i ati i të paditurit, kurse nga viti 1997, në bazë të aktvendimit mbi trashëgiminë T.nr. 42/97 të datës 21.05.1997, e njëjta kalon në emër të këtu të paditurit dhe vazhdon të evidentohet edhe sot e kësaj dite. Kontestuese paraqitet të jetë fakti i posedimit të njëjtës, mirëbesimi dhe ligjshmëria e këtij posedimi eventual nga ana e paditësve. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësit nuk kanë dëshmuar faktin se janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi ngastrën Kadastrale kontestuese sipas usucapio. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në anën e të paditurit ekziston një vazhdimësi të së drejtës së pronësisë për ngastrën Kadastrale kontestuese dhe atë që nga fillimi i regjistrimit në kadastër nga viti 1932, e deri më sot dhe për gjykatën e shkallës së parë ka qenë e qartë se këto ndryshime nuk kanë ndodhur ex officio, por me kërkesën e palës së interesuar asokohe. Pra këto fakte gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në bazë të historiatit dhe ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë. Njëherit gjykata e shkallës së parë në lidhje me faktin e posedimit ka vlerësuar se i njëjti duhet të jetë edhe me mirëbesim, por edhe i ligjshëm nga poseduesi i pretenduar, e sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar me dëgjimin edhe të dëshmitarëve dhe provave tjera paditësit me asnjë provë të bindshëm nuk kanë mundur të provojnë as faktin e shfrytëzimit-posedimit aktual dhe të pandërprerë të ngastrës Kadastrale kontestuese nga ana e tyre, as faktin e mirëbesimit të tyre në shfrytëzimin eventual të njëjtës, e as ligjshmërinë e këtij shfrytëzimi eventual nga ana e tyre, , për më tepër që edhe për palët ndër gjyqës është fakt i qartë dhe jokontestuese se e njëjta ngastër është në pronësi të paditurit dhe është e pa mundur që paditësit gjatë kësaj periudhe asnjëherë të mos e kenë ditur që kjo paluajtshmëri nuk evidentohet në emër të tyre por në emër të paditurit, e në ndërkohë të i padituri ekziston kontinuiteti i pashkëputshëm i të drejtës së pronësisë dhe atë dy here e bartur nga paraardhësit e tij, përkatësisht përfundimisht në emër të tij. Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka pasur parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit të dhënë në aktvendimin CA.3271/2012 nga data 17.03.2015. Vendimi bazohet në nenin 143, ndërsa ai për shpenzimet në nenin 452 par.1 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m), në të cilat kjo gjykatë kujdesohet sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa e paditësit e posaçërisht të nenit 182 par.2 pika n). Kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të goditur është i qartë, nuk është kundërthënës, përkatësisht kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit. Njëherit në aktgjykimin e goditur me ankesë janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare dhe ato janë të qarta.

Njëherit Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar edhe gjendjen faktike se ngastra Kadastrale kontestuese nga viti 1932 evidentohet në emër të paditurve, përkatësisht gjyshit, pastaj të atij dhe sot në emër të paditurit, e mbi bazën e aktvendimit mbi trashëgimin T.nr.42/97 të datës 21.05.1997, dhe vazhdon të evidentohet edhe sot. Përndryshe gjykata e shkallës së parë me provat e administruara dhe të vlerësuara siç është ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, dëgjimi i dëshmitarëve dhe provave të tjera, drejtë ka vërtetuar se paditësit në asnjë mënyrë nuk kanë dëshmuar faktin se janë posedues të pa ndërprerë të ngastrës Kadastrale kontestuese në vazhdimësi, e as mirëbesimin, si dhe ligjshmërinë, ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore për të fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, përkatësisht të nenit 28 par.4 të LMTHJP, ndërsa në anën tjetër i padituri ka në vazhdimësi të drejtën e pronësisë që nga viti 1932 dhe kjo ngastër nga ky vit ka qenë i evidentuar në emër të gjyshi të tij deri në vitin 1944, kur kalon në emër të babait të tij dhe përfundimisht në vitin 1997, me trashëgimi kalon në emër të këtu paditurit, prandaj edhe për këtë gjykatë është e qartë se të gjitha këto ndryshime në evidencë të ngastrës kontestuese janë bërë me kërkesa përkatëse të palëve të interesuar, përkatësisht të paraardhësve të paditurit dhe të vet paditurit, andaj edhe për këtë gjykatë është e pa mundur që paditësit për gjithë këtë periudhë kohore të mos dinë se paluajtshmëria kontestuese është i evidentuar në emër të paditurit dhe paraardhësve të tij dhe nuk është prona e tyre .

Prandaj, pranë gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë me zbatim të drejtë të drejtës materiale gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se paditurit nuk kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazë e mbajtjes (parashkrimit) e në kuptim të nenit 28 par.4 të LMTHJP, me të cilën është paraparë që poseduesi me mirëbesim të sendit të paluajtshëm, në të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë në atë send me mbajtje, përkatësisht me parashkrim pas kalimit të kohës prej 20 vite.

Kjo gjykatë vlerësoi edhe thëniet e tjera ankimore dhe gjeti se janë të pa bazuara dhe pa ndikim në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo që ka marrë gjykata e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195. par. 1 pika d) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1573/17 me dt.09.09.2021**

**Kryetari i kolegjit – gjyqtari**  
**Kujtim Pasuli**